



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA SKRAPAR  
AUDITI I BRENSHEM**

Nr 396/1 Prot

Skrapar me 108 102 / 2019

MIRATOHET  
KRYETARI I BASHKISË  
NESIM SPAHIU



**RAPORT I AUDITIT TE BRENSHEM PER VITIN 2018.**

**I. Permbledhje.**

Auditi I Brendshem bashkia Skrapar ka ushtruar veprimtarine audituese bazuar ne planin vjetor te kontrollit per vitin 2018 konfirmuar nga Kryetari i Bashkise .Nje vemendje te posacme i eshte kushtuar ceshtjeve qe lidhen me vleresimin e menaxhimit financiar dhe kontrollin,aktivitetit ekonomik financiar,prokurimeve me fonde publike,taksave dhe tarifave ,planifikimin, realizimin e te ardhurave dhe shpenzimeve,zbatimi e menaxhimi i buxhetit,organizimit e mbajtjes se kontabilitetit,dhe ne pergjithesi zbatimi I ligjeshmerise ne te gjithe sektoret vartes.Veprimtaria audituese ka funksionuar me ato programe qe kane riske te larte ne realizimin e objektivave.Krahas punes se mire u konstatuan problem per te cilat jane dhene masa zhdentimi si dhe rekomandime sipas prioriteteve.

**II. Baza Ligjore .**

Veprimtaria e Auditit te Brendshem eshte mbeshtetur ne procedurat e percaktuara ne zbatim te Ligjit 114,date 22.10.2015"Per Auditimin e Brendshem ne Sektorin Publik"dhe Manualin e Auditimit te Brendshem te dates 31.10.2016 si dhe ne programin e auditimit vjetor te vitit 2018 te miratuar nga kryetari i bashkise.

**III. Organizimi**

Qellimi i planit strategjik dhe misioni i NJAB eshte ti jape siguri objective,te pavarur dhe sherbime konsultative te dizenuara per te ritur vlerat per nje menaxhim efektiv te burimeve materiale e njerezore.

Auditi i Brendshem I bashkise ka nje punonjes i cili mbulon auditin e bashkise,ky punonjes eshte me arsim te larte i diplomuar ne fakultetin e ekonomik (finance) me pervoje pune por i pa cetifikuar si audit i brendshem ne sektorin publik.Varesia e Njesise se Auditimit te Brendshem Bashkia Skrapar.

**IV. Rezultatet e veprimtarise se AB per Vitin 2018.**

-Per vitin 2018 audit i bashkise ka programuar gjithesej 8 audite , nga te cilat 3(tre) Auditime .te perputheshmerise,2(dy) Auditim .financiar ,3(tre) Auditim te.kombinuar.Nga programi vjetor I miratuar jane realizuar 4(kater ) auditime ,kater auditime nuk eshte realizuar per arsye objective).

Me poshte paraqesim numrin dhe llojin e angazhimit ,periudhen e audituar,gjetjet nga auditimi ,rekomandimet e lena ,zbatimi I rekomandimeve ne subjektete e audituara.

**• Auditimi ne (Sektori I finances)**

Nga auditimi i kryer ne kete subject per periudhen 01.06.2017 – 30.06.2018

Konstatojme:

Mangesi ka ne zbatim te udhezimit nr 30 date 27.12.2011 "Per menaxhimin e aktiveve ne njesit e sektorit public" kap IV "Sistemit te kontrollit periodic te aktiveve" mbi pergjegjesit qe ka komisioni per inventarizimin sipas natyres se aktiveve, mbi mangesit e konstatuara lidhur me dokumentacionin shoqeruese te flete hyrjeve e flet daljeve te magazines.

Mangesi ne zbatim te ligjit 10296 date 8.7.2011 "Per menaxhimin financiar dhe kontrollin" per krijimin e komisioneve per inventarizimin e aktiveve, si dhe udhezimit nr 30 date 27.12.2011 "Per menaxhimin e aktiveve ne njesit e sektorit public".

Mangesi ne zbatimin e Udhezimit te Ministrit te financave nr 14 date 28.12.2006, kreull –te pika 3, Procedurate e rakordimit dhe tembylljes se llogarive" (permbledhjesja e debi kredive e ditareve per vitin 2018).

Gjithashtu ne kete sektor per gjetjet e konstatuara jane lene dhe 7 (shtate) rekomandime te cilat jane ne proces zbatimi.

#### • **Auditimi ne Drejtorine e sherbimit pyjor.**

Nga auditimi I plote ne kete subject per periudhen 01.01.2017- 31.12.2017.

Nga auditimi I ushtruar "Mbi Auditimin e zbatimit te Ligjshmerise dhe rregullshmerise dhe zhvillimit te veprimtaris se perdorimit te burimeve financiare ,ruajtjen, administrimin, menaxhimin dhe perdorimin e fondit pyjor kombetar te tokes pyjore e burimeve natyrore te menaxhimit te pasurive te paluajtshme, jane konstatuar :

Mangesi ne zbatim te ligjit 9632 date 30.10.2006 "per sistemin e taksave vendore" te ndryshuar, lidhur me hartimin planifikimin e te ardhurave pyjore e jo pyjore.

Mangesi ne plotesimin dhe pasqyrimin e sakte te aktiveve te qendrueshme te trupezuara, bazuar ne ligjin 9228 date 29.4.2011 "Per kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", dhe ligjit ligjit 10296 date 8.7.2011 "Per menaxhimin financiar dhe kontrollin".

Mangesi ne hartimin e kontratave ku nuk percaktohen te gjitha te dhenat ne tabelat perkatese ose pjese te kontrates ,sasia e vlere ne lek.

Ne kete sector per gjetjet jane lene 5 masa rekomanduese te cilat jane ne proce zbatimi.

#### • **Auditimi ne sektorin I sherbimeve bujqesore mjedisor, veterinare e transportit.**

Nga auditimi I kryer ne kete subject per periudhen 01.01.2017 – 31.12.2017.

Konstatojme:

Mangesi ne programimin dhe realizimin korekt te te ardhurave sipas ligjit 8308 date 18.3.1998 "Per transportin rrugor" I peerditesuar.

Mangesi ne numrin e linjave ne njesi administrative te caktuara.

Mangesi ne percaktimin dhe respektimin e korekt te vende nisjes e vende ndalimit.

Per kete sektor per gjetjet e konstatuara u lane 4 (kater) te cilat jane ne proces zbatimi

#### • **Auditimi ne Ndermarjen e Sherbimit Publik..**

Nga auditimi I plote ne kete subject per periudhen 01.01.2017- 30.03.2018.

Konstatojme:



Mangesi ne zbatimte ligjit 9632 date 30.10.2006 „Per sistemin e taksave“i ndryshuar,ligjit 9920 date 19.05.2008 „per procedurat tatimore ne RSH“ ne hartimin e zbatimin e normave te programimit me parashikimin e te ardhurave e vjeljen e tyre.

Mangesi ne plotesimin e dosjeve te personelit sipas VKM nr 355 date 07.07.2000“Per plotesimin e dosjes seregjistrit te personelit“ ,pika3.

Ne kete sektor per gjetjet e konstatuara jane lene dhe 4(kater) rekomandime te cilat jane ne proces zbatimi.

#### **V.Rekomandimet.**

Nga auditimet e ushtruara ne subjektet e bashkise sipas sektoreve te kontrolluara jane lene 20 (njezet ) masa rekomanduese perkatesishte:

- Rekomandime te permiresimit te sistemeve 10 ( dhjete) te cilat jane proces evadimi
- Rekomandime te karakterit organizative 7(shtate) ne proces evadimi
- Rekomandime te tjera 3(tre ) jane proces evadimi.

#### **VI.Monitorimi I Sistemit te Cilesise.**

Per periudhen raportuese kemi marre pjese ne seminare e trajnime te zhvilluar nga Drejtoria e Pergjitheshme e Harmonizimit te Kontrollit te Brendshem Financiar Publik(Drejtoria per Auditimin e Brendshem) si dhe nga Drejtoria e Pergjitheshme e Harmonizimit te Kontrollit te Brendshem Financiar Publik (Drejtoria e Harmonizimit te Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit),jemi ne pritje per tu angazhuar ne trajnime e kualifikime te vijueshme ,qe do ta hartohen dhe implementohen nga NJQH/AB ne vijuesheri.

#### **VII.Analiza e Kapaciteteve Audituese.**

Gjate vitit 2018 njesisa audituese ka funksionuar vetem me nje auditues e cila ka sjelle veshtiresi ne mbulimin e auditimit te te gjitha aktiviteteve te njesise publike.Kapaciteti auditues perbehet nga nje specialist aktualisht, i pa cetifikuar ,me 3 (tre) vite pervoje si auditues dhe 29 vjet pune ne profesion.

#### **VIII.Konkluzionet.**

- Funksionimi i auditëve me ato programe qe kane riske me te larte ne realizimin e objektivave.
- Plotesimi I objectives se auditimeve per te dhene siguri objective te arsyeshme dhe dhenien e keshillave per nje menaxhim sa me efektiv te burimeve material njerezore.
- Radhitja e zonave qe kane te bejne me vleresimin e plotesimit te objektivave dhe analizen e riskut ne zbatim te akteve ligjore e nenligjore etj.
- Jemi angazhuar per te respektuar rregullat dhe kriteret e percaktuara ne Manualin e Auditit te Brendshem,gjate hartimit dhe perpilimit te dokumentacionit si:

Fillimi I misionit te auditimit,takimi prezantues,mbajtja e process verbaleve dhe akt verifikimeve ,hartimi I project raportit ,takimi pajtues,dhe observacionet,hartimi I raportit perfundimtar dhe rekomandimet perkatese,ndjekja e rekomandimeve etj.

Ritja e cilesise se auditimeve dhe aplikimi I standarteve ngelen synimi jone ne vazhdimesi.

Bashkangjitur raportit te realizimit te programit jane pasqyrat 1,2,3,4,5,6.

Duke ju falenderuar per bashkpunimin!

**AUDIT I BRENDSEHEM**

**DONIKA SPAHO**